REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES
01.Numër: 060/01-70410,dt. 24 Shtator 2026

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2.pika d) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008"), nenit 8 paragrafi 1. të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurat e themelimit, organizimin dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, nenit 20.paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, në Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 24 Shtator 2026, merr këtë:

VENDIM
Nr. 94/2026
Mbi shpalljen Konkursit për zgjedhjen e anëtarëve të ri të Komiteteve Konsultative

1.MIRATOHET Vendimi për shpalljen – publikimin e Konkursit për zgjedhjen e anëtarëve të ri, në vend të Komiteteve Konsultative:

1.1. Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik,
1.2. Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit dhe
1.3. Komitetit Konsultativ për persona me aftësi te kufizuara.

2. Anëtarët e komiteteve konsultative zgjidhen nga radhët e qytetarëve dhe duhet të jenë njohës – ekspert të fushave përkatëse.

3. Për Zbatimin e këtij Vendimi dhe përcaktimin e kritereve për zgjedhjen e anëtarëve të ri të komiteteve konsultative, do të kujdeset kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Njësinë e Personelit.

4. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E PEJËS KUVENDI KOMUNËS PEJË SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ OPŠTINA PEĆ REPUBLIKA KOSOVO

KRYESUESI I KUVENDIT
z. Rexhep Kurtbogaj

Dërgohet:
MAPL.
Kryesuesi i Kuvendit.
Kryetarit të Komunës
Njësisë së Personelit.
Arkivë.